



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

V E N D I M

Nr. 63 Datë 03.12. 2007

Për vendosje gjobe ndaj Shoqërisë ProCredit Holding AG

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali Zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 3.11. 2007, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Pa saktësi në njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të pjesës në total së 36.25 % të aksioneve në ProCredit Bank Sh.A nga ProCredit Holding A.G.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 73, pika 1, shkronja b, nenet 10-12, në veçanti Kreu IV “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, neni 80, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për Njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit për përqendrimin e njoftuar, dëgjimit të palëve, përfaqësuar nga ProCredit Bank dhe pas administrimit të shkresës Nr TH3647 Prot të Procredit

Bank, datë 16 Nëntor 2007 dhe me Nr 549 Prot, datë 16 Nëntor 2007, të Autoritetit të Konkurrencës,

V Ë R E N S E:

1. Palët në transaksion:

- **ProCredit Holding A.G, blerësi** i pjesës prej 36.25% të kapitalit aksionar të ProCredit Bank Sh.A, që përfshin 25% të kapitalit aksionar të FEFAD dhe 11.25% të kapitalit aksionar të IFC-së,.
- **FEFAD** (Fondacioni për financimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme private), shitësi, i pjesës prej 25% të kapitalit aksionar të barabartë me 40.000 aksione, me vlerë 2.956.000 Euro,
- **IFC** (Korporata Ndërkombëtare Financiare) shitësi i pjesës prej 11.25% të kapitalit aksionar të barabartë me 18.000 aksione, me vlerë 1.330.200 Euro në PCB Sh.a,

në datën 8 qershor 2007, kanë lidhur një marrëveshje për përfitim e kontrollit nga ProcreditHolding AG për 36.25% të kapitalit aksionar, në ProCredit Bank Sh.A.

2. Informacioni i siguruar nga ProCredit bank lidhur me datën e nënshkrimit të marrëveshjes nuk është i saktë dhe nuk është i plotë, duke krijuar mospërputhje me kërkesën për njoftim të përqendrimit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 e ligjit 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

3. Veprimi i mësipërm konsiderohet shkelje sipas nenit 73, pika 1, shkronja b.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 12, pika 2, nenit 55, pika 1, nenit 73 pika 1, shkronja b, neni 80 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

VENDOSI:

1. Gjobë ndaj shoqërisë ProCredit Holding A.G, në shumën 7 237 464 lekë.
2. Në mbështetje të nenit 80 të Ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Policia Tatimore kryen ekzekutimin e gjobës në shumën e mësipërme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

(_____)
Zv/Kryetar

Servete Gruda

(_____)
Anëtar

Koço Broka

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R